

---

*Shëndeti është e drejta ime: Monitorimi i spitaleve për listën e barnave esenciale, në përputhje me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për rritjen e transparencës dhe respektimin e të drejtave të pacientëve*



Prill 2019

---

**Botues:** Shoqata Together for life

Rr. Brigada VIII, Nd.8, H.16, Ap.14

info@togetherforlife.org.al

Tiranë, ALBANIA

**Raporti u përgatit nga:**

Eglantina Bardhi – Udhëheqës Kryesor i Projektit

Denisa Canameti – Koordinatore e Projektit

**Ekspert ligjor:** Andi Muratej

**Facilitatorë të procesit:**

Blertina Koka

Ilma Lamçe

Kesilda Gjoka

Ky monitorim u realizua nga shoqata “Together for life” në kuadër të projektit “Shëndeti është e drejta ime: Monitorimi i spitaleve për listën e barnave esenciale, në përputhje me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për rritjen e transparencës dhe respektimin e të drejtave të pacientëve”, të mbështetur nga Ambasada Amerikane në Tiranë.

*Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autor-it/ve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit*

---

## PËRMBAJTJA E LËNDËS

|   |  |
|---|--|
| <b>Hyrje .....</b>  |  |
| 1.1 Parathënie për monitorimin .....  |  |
| 1.2 Kuadri Ligjor.....  |  |
| 1.3 Moduli i Monitorimit .....  |  |
| 1.4 Lista e Barnave Esenciale, Urdhri i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale .. |  |
| <br>  |  |
| <b>Gjetjet nga monitorimi.....</b>  |  |
| 2.2 Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza.....   |  |
| 2.3 Spitali i Lezhës.....   |  |
| 2.4 Spitali i Fierit.....   |  |
| 2.5 Perceptimi Qytetar për Listën e Barnave Esenciale.....                                  |  |
| 2.6 Perceptimi i Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor për Listën e Barnave Esenciale.....       |  |
| <br>  |  |
| <b>Përfundime dhe Rekomandime.....</b>  |  |

---

# Hyrje

Shoqata Together for life në kuadër të projektit “Shëndeti është e drejta ime: Monitorimi i spitaleve për listën e barnave esenciale, në përputhje me urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për rritjen e transparencës dhe respektimin e të drejtave të pacientëve”, të mbështetur nga Ambasada Amerikane në Tiranë, realizoi monitorimin e 3 spitaleve : Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Spitalit Rajonal të Lezhës dhe Spitalit Rajonal të Fierit, gjatë periudhës nëntor 2018 -mars 2019.

Synimi i këtij monitorimi ishte evidentimi i pranisë ose jo të Listës së Barnave Esenciale në spitale, që sipas Urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duhet të shpallet në çdo pavijon dhe shërbim urgjence dhe drejtorët e spitaleve do të jenë përgjegjës nëse do të ketë mungesa të këtyre barnave<sup>1</sup>.

Sipas Ministres së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në vitin 2018 është arritur një marrëveshje kuadër, e cila i jep fund një herë e mirë barnave stok në spitale, shmang skadencat dhe mbulon nevojat me barnat esenciale për pacientët.

35 milion euro financohen për barnat dhe pajisjet mjekësore në spitalet tona.

Autoritetet shtetërore kanë përgjegjësi për garantimin e barabartë të të drejtave dhe lirive themelore, pavarësisht gjendjes shëndetësore apo aftësisë së tyre të kufizuar.

Kushtetuta jonë parashikon se, shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon standardin më të lartë shëndetësor, fizik e mendor, të mundshëm për shtetasit e tij. Ky angazhim kushtetues nënkupton që, shteti duhet në mënyrë të vazhdueshme punojnë të arrijë standardin më të lartë shëndetësor përmes rritjes së mbështetjes financiare, kualifikimit të personelit, lehtësimin e procedurave, etj.

Ligji nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar, përcakton që: “E drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë themelore e individit, se kujdesi shëndetësor bazohet në mosdiskriminim, efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit, duke

<sup>1</sup> <http://www.shendetesia.gov.al/manastirliu-transparence-ne-spitale-lista-e-barnave-do-shpallet-ne-cdo-urgjence/>

---

garantuar sigurinë e pacientit dhe paanësinë, se ky shërbim realizohet duke përfshirë aktorët e ndryshëm, si pacientët, konsumatorët dhe qytetarët dhe bazohet në llogaridhënien ndaj qytetarëve”<sup>2</sup>.

Në nenin 8, të Ligjit nr. 9106, date 17.7.2003, “Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se: “Spitalet detyrohen të zbatojnë të drejtat e të sëmurëve të shtruar, sipas "Kartës së të drejtave të pacientit", të pranuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.” Karta Shqiptare e të Drejtave të Pacientit, miratuar me Urdhrin nr. 657, dt. 15.02.2010, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale garanton të drejtat e pacientëve në raport me ofrimin e shërbimit shëndetësor nga institucionet shëndetësore publike apo private.

Në këto të drejta përfshihen e drejta për Akses, e drejta për Informim, e drejta për të marrë shërbim shëndetësor Cilësor të Standardeve të Larta, e drejta për të përfituar nga novacionet dhe arritjet bashkëkohore mjekësore, e drejta për Trajtim në Bazë të Veçorive Individuale, e drejta për Ankimim, e drejta për Kompensim dhe e drejta për të Marrë Pjesë Aktivisht në Politikë-bërjen në fushën e shëndetësisë dhe Përmirësimin e Cilësisë në sistemin shëndetësor

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është institucioni qendror përgjegjës për politikën e sistemit shëndetësor si dhe për koordinimin e të gjithë aktorëve brenda dhe jashtë sistemit. Sistemi i kujdesit shëndetësor në Shqipëri mbështetet edhe nga një sërë institucioneve në varësi të kësaj Ministrie<sup>3</sup>.

### 1.3 MODULI I MONITORIMIT

Para fillimit të monitorimit në spitale është përgatitur një modul monitorimi nga një ekspert me njohuri mbi metodologjinë e monitorimit dhe funksionimit të sistemit të kujdesit shëndetësor. Ky modul ka ofruar udhëzime hap pas hapi në procesin e monitorimit. Gjithashtu, ka shërbyer si referencë dhe udhëzues për ekspertët e përfshirë. Struktura e këtij moduli ndjek bazën ligjore për të drejtën e shëndetit, si dhe përshkruan objektin e monitorimit .

*Ky modul ofron informata themelore për sa vijon:*

- Baza ligjore e Shëndetit Publik
- Elementet kritikë të një monitorimi

---

<sup>2</sup>Neni 2, i Ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë“, i ndryshuar

---

**Objekti i monitorimit:** shpallja fizike e listës së barnave në çdo pavion dhe shërbim urgjence në spitalet publike.

Monitorimi është zhvilluar sipas një Pyetësoari të përgatitur paraprakisht, i cili përmban rubrikat me informacionin e nevojshme për të vlerësuar se si zbatohet kjo detyrë nga spitalet publike.

Monitorimi është bërë në spitalet publike, pa njoftim paraprak, nga grupe të përbëra me të paktën dy vëzhgues të trajnuar për këtë qëllim.

Brenda 3 ditëve nga kryerja e monitorimit në spital, grupi i vëzhguesve ka përgatitur një Raport të detajuar dhe të saktë lidhur me gjetjet e konstatuara dhe konkluzionet e monitorimit.

Të dhënat më thelbësore dhe konkluzionet e dalta nga këto raporte janë pjesë e këtij Raporti Përfundimtar lidhur me monitorimin e zbatimit të detyrimit për shpalljen e listës së barnave esenciale në çdo pavion shërbimi apo urgjence.

Ky Raport bashkë me rekomandimet do t'i dërgohet zyrtarisht institucioneve qendrore si Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në Kuvendin e Shqipërisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, etj.

#### 1.4 PËRSHKRIM I URDRIT PËR AFISHIMIN E LISTËS SË BARNAVE ESENCIALE

Me Urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, asnjë pacient apo familjar nuk duhet të drejtohet të blejë barnat esenciale jashtë spitalit. Lista esenciale e barnave duhet të shpallet në çdo pavijon dhe shërbim urgjence dhe drejtorët e spitaleve janë përgjegjës nëse do të ketë mungesa të këtyre barnave.

Sipas këtij institucioni, duhet që çdo pavijon dhe shërbim urgjence pranë spitaleve publike të publikojnë listën e barnave esenciale, në një vend të aksesueshëm, për pacientët apo familjarët e tyre. Ky publikim duhet të bëhet në respektim të detyrimeve ligjore që kanë këto autoritete shëndetësore si dhe në përputhje me Kartën Shqiptare të të Drejtave të Pacientit. Sipas Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në v. 2018 është arritur një marrëveshje kuadër, e cila i jep fund barnave stok në spitale, shmang skadencat dhe mbulon nevojat me barnat esenciale për pacientët. *“Ne financojmë sot rreth 35 milion euro për barnat dhe pajisjet mjekësore në spitalet tona. Dhe nëse një spital si Fieri apo Vlora i ka barnat, nuk ka arsye pse të mungojnë në Durrës apo diku tjetër. Pra është çështje menaxhimi”*, ka thënë Ministria e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Teksa lajmëroi hapjen e një kursi intensiv për menaxhim shëndetësor për 40 drejtuesit e spitaleve, ajo u shpreh se puna e tyre do të matet me performancën që ata do të kenë dhe çështja e furnizimit me barna është patjetër një prej elementëve që do të duhet të përmbushet.

---

Mbështetur në këtë urdhër të Ministres së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale<sup>4</sup>, Shoqata “Together for Life”, ka kryer monitorimin e 3 spitaleve rajonale, përkatësisht: Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitalit Rajonal të Lezhës dhe Spitalit Rajonal të Fierit. Objekt monitorimi ishte shpallja fizike e Listës së Barnave Esenciale në çdo pavion dhe shërbim urgjence në këto tre spitale publike.

---

# GJETJET NGA MONITORIMI

---

Projekti "Shëndeti është e drejta ime: Monitorimi i spitaleve për listën e barnave esenciale, në përputhje me urdhrin e Ministrit për rritjen e transparencës dhe respektimin e të drejtave të pacientëve" ka synuar monitorimin e zbatimit të Urdhrit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për afishimin në secilin pavijon dhe shërbimin urgjence të listës së barnave esenciale në 3 spitale në Shqipëri: Tiranë, Fier dhe Lezhë. Aktivitetet e projektit janë përqendruar në monitorimin, vlerësimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e pacientëve dhe publikut në përgjithësi lidhur me të drejtën për shërbime të kujdesit shëndetësor adekuat.

## 2.2 QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"

Në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, janë kryer 4 monitorime në 36 shërbime/pavijone dhe në 3 urgjenca të kësaj qendre. Gjatë monitorimit ka rezultuar se, Lista e Barnave Esenciale është afishuar vetëm në shërbimet e Urgjencës. Ndërsa, është konstatuar se, Lista e Barnave Esenciale nuk është afishuar në pavijone, sipas njoftimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Bazuar në Ligjin nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", Shoqata "Together for Life" i është drejtuar përmes një shkrese zyrtare Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë për të marrë informacion lidhur me Listën e Barnave Esenciale, publikimin e listës dhe vështirësitë e mundshme të sigurimit të kësaj liste. Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, përmes shkresës zyrtare nr. 374/1, është përgjigjur se:

*"Në përgjigje të Shkresës tuaj nr. 176 administruar në QSUT "Nënë Tereza" me nr. 374 prot., mbi pikat mbi të cilat kërkonit të informoheni ju vëmë në dispozicion informacionin e mëposhtëm:*

*Lista esenciale e barnave është afishuar në çdo shërbim urgjence dhe pavijon në QSUT. Afishimi/ Publikimi i Listës së Barnave Esenciale nuk lidhet domosdoshmërisht me disponimin e një urdhëri nga ana e MSHMS por buron nga detyrimi që ka QSUT për të bërë publike dhe për të qenë transparent me pacientin lidhur me barnat esenciale që gjenden në spital. QSUT bazuar në procedurat e prokurimit të marrëveshjes kuadër ka arritur të sigurojë 90% të medikamenteve që përmban Lista e Barnave Esenciale. Fakti që me Marrëveshjen kuadër mbulohen nevojat për medikamentet që përmban Lista e Barnave Esenciale në asnjë nga shërbimet në QSUT nuk janë paraqitur vështirësi për sigurimin dhe furnizimin me barnat bazë të listës."*

Ndërsa, nga monitorimet e kryera nga ana e Shoqatës "Together for Life" ka rezultuar se, Lista e Barnave Esenciale ishte e afishuar vetëm në shërbimet e Urgjencës dhe nuk ishte e afishuar në pavijonet e tjera të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë.

---

## 2.3 SPITALI RAJONAL LEZHË

Në Spitalin Rajonal Lezhë janë realizuar 3 monitorime me objekt konstatimin e shpalljes fizike të Listës së Barnave Esenciale në 8 shërbime/pavijone dhe në 3 shërbime të Urgjencës. Gjatë monitorimeve të kryera ka rezultuar se, Lista e Barnave Esenciale është afishuar në 3 shërbimet e Urgjencës. Monitoruesit kanë vërejtur se, në të tre shërbimet e Urgjencës është afishuar një Urdhër me nr. 179, date 08.08.2018, i Drejtorit të Spitalit Rajonal Lezhë ku thuhet se, të gjitha medikamentet për përdorim spitalor ndodhen në farmacinë e spitalit. Në shërbimin e Ortopedisë ishte afishuar lista e materialeve bazë që siguron spitali.

Ndërsa, nuk rezultoi që Lista e Barnave Esenciale të ishte afishuar në 4 pavijonet/shërbimet e tjera.

Shoqata “Together for Life” i është drejtuar Spitalit Rajonal Lezhë me një shkresë zyrtare ku kërkon informacion lidhur me afishimin e listës së barnave esenciale dhe nëse ka patur vështirësi në sigurimin e këtyre medikamenteve nga ana e institucionit. Spitali Rajonal Lezhë është përgjigjur se:

*“Në përgjigje të Kërkesës suaj me nr prot. 175, protokolluar pranë Institucionit tonë me nr prot. 68 në të cilën kërkon informacion lidhur me zbatimin e Urdhrit për Transparencën e Listës së Barnave Esenciale ju informojmë si më poshtë:*

*Në Spitalin Rajonal Lezhë është shpallur Lista e Barnave Esenciale në të gjitha repartet e Spitalit përfshirë edhe Urgjencën.*

*Shërbimet në të cilat është shpallur kjo liste janë:*

*1- Urgjencë adulte*

*2- Reanimacion Spital*

*3- Urgjencë pediatrike*

*4- Kirurgji*

*5- Ortopedi*

*6- Pediatri*

*7- Patologji*

---

8- Reanimacion Maternitet

9- Urgjencë Maternitet

10- Obstetrikë

11- Gjinekologji

*Nuk kemi pasur vështirësi në sigurimin e medikamenteve dhe materialeve të mjekimit nga ana e Spitalit tonë.”*

Nga kjo përgjigje e Spitalit Rajonal Lezhë thuhet se: “Në Spitalin Rajonal Lezhë është shpallur Lista e Barnave Esenciale në të gjitha repartet e Spitalit përfshirë edhe Urgjencën....”. Por nga verifikimi në vend, i kryer nga Shoqata “Together for Life” rezulton se, kjo listë ishte e afishuar vetëm në shërbimet e Urgjencës dhe të Ortopedisë. Ndërsa, në 4 pavijonet/shërbimet e tjera nuk u konstatua afishimi i kësaj liste.

## 2.5 SPITALI RAJONAL FIER

Në Spitalin Rajonal Fier janë kryer 3 monitorime me objekt monitorimin e shpalljes fizike të Listës së Barnave Esenciale në shërbime/pavijone dhe në urgjenca. Gjatë monitorimeve të kryera ka rezultuar se, Lista e Barnave Esenciale është afishuar në shërbimet e Urgjencës dhe në pavijone. Ndërkohë që rezultoi se, Lista e Barnave Esenciale nuk është afishuar vetëm në shërbimin e Pediatriisë.

Shoqata “Together for Life”, iu drejtua me Kërkesë për informacion Spitalit Rajonal Fier. Në përgjigjen zyrtare të dërguar ky institucion ka informuar se: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar dhe ka përcjellë në çdo spital të Republikës së Shqipërisë, Listën e Barnave Esenciale në Shërbimin e Urgjencës. Kjo Listë e Barnave Esenciale në Shërbimin e Urgjencës, sipas Udhëzimeve të MSHMS, është shpallur në vende të dukshme në ambientet e spitalit, Shërbimit të urgjencës, në mënyrë që të jetë e aksesueshme nga çdo qytetar. Lidhur me sigurimin nga ana e Spitalit të medikamenteve që përmban lista e sipërpërmendur, deri më tani nga ana jonë nuk ka patur vështirësi në sigurimin e tyre.

## 2.6 PERCEPTIMI QYTETAR PËR LISTËN E BARNAVE ESENCIALE

Në mënyrë që të informohen pacientët dhe qytetarët në listën esenciale të barnave, janë organizuar 4 seanca informimi me pacientët dhe shoqatat e pacientëve. Nga takimet me pacientët dhe qytetarët ka rezultuar se, afishimi i Listës së Barnave Esenciale në Spitale, mund të ketë rritur transparencën, por nuk ka ndikuar mjaftueshëm në përmirësimin e situatës për

---

medikamente në Urgjencë, veçanërisht për pacientët në Fier dhe në Lezhë. Ndërkohë, gjendja paraqitet më e kënaqshme për pacientët në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Gjatë takimeve me qytetarët në Tiranë, janë shprehur se në raste të rralla janë detyruar të blejnë medikamente jashtë spitalit. Problemi më i shprehur prej tyre është koha e pritjes në Urgjencën e QSUT-së dhe mungesa e ambienteve të përshtatshme për marrjen e shërbimit.

Ndërkohë pacientët në Lezhë dhe në Fier kanë raportuar mungesa të theksuara të ilaçeve esenciale në Urgjenca.

*QSU Nënë Tereza* - Barnat e vetme që mund të blihen në Urgjencë janë tableta. Të paktën flas për QSUT . Është amiodaroni e cila përdoret si dozë ngopëse për disritmitë kardiake që me vështirësi konvertohen.

*QSU Nënë Tereza* - Po kam blerë në urgjencën e zemrës kam blerë kolderonin tableta.

*QSU Nënë Tereza* - Në urgjencë kam vajtur me temperaturë 35.5 e as e ka vënë ujin në zjarr Urgjenca Mjekë, që ia mbathin kur sapo vjen një pacient i sëmurë ! Boll më ! Na ndritët me këtë urgjencën e shtetit !

*QSU Nënë Tereza* – Kam shkuar në urgjencën e QSUT-së me hemoglobinë shumë të ulët. Kur je në urgjencë nuk të bie shumë mendja që të lexosh listën e barnave apo gjërat e tjera të afishuara, por ajo që di të them është se në orën 3 që kam shkuar unë ishte vetëm një mjek i ri, që mesa mora vesh ishte specializant. Më vonë erdhi një mjek që ishte mjeku roje dhe deri kur kam lëvizur për në pavion, ishte vetëm një mjek që përballonte një numër shumë të lartë pacientësh. Nuk kam blerë ilaçe jashtë shërbimit. Vetëm të afërmit kanë dhuruar gjak, për gjakun që merrja unë, por kjo është praktikë normale dhe e di. Ajo që është problem në urgjencë, është koha e gjatë e pritjes për të të ardhur mjeku te koka, dhe “lufta” për një krevat që të marrësh shërbim.

*QSU Nënë Tereza* – Çova familjarin tim me temperaturë 41, fillimisht tek Qendra Shëndetësore e lagjes, ku i bënë një gjilpërë për uljen e temperaturës,dhe i tha që nëse të rritet sërish temp duhet të shkosh në QSUT. Tek Qendra Shëndetësore (te rruga e Kavajës) e kemi blerë Për 30 minuta iu ul temp dhe për 2 ore temperatura iu rrit prap 41. Në këto kushte e çuam tek urgjenca e infektivit në Qsut. Nuk kemi blerë asnjë ilaç. Thjesht kemi marrë një recetë kur kemi dalë nga urgjenca.

*Lezhë* – Shkojmë në urgjencë dhe serumin duhet ta blejmë vetë, nuk del nga urgjenca po nuk shkove një herë në farmaci.

*Lezhë* –As nuk e lexojmë fare listën, as nuk dimë ta lexojmë fare listën. Kur na thotë mjeku shko bli në farmaci, do shkojmë. Ça do bësh në urgjencë? Do thuash prit të lexoj ca ka lista dhe nëse

është në listë nuk shkoj ta blej kur familjari po të vdes aty? Kjo ska kuptim. Ne duam të na ofrohet shërbim, kaq. Sna intereson fare lista.

*Fier-* Për rastet e rënda na çojnë në Tiranë. Të shkosh në urgjencë dhe të mos blesh asnjë ilaç, nuk besoj se ka ndodh ndonjëherë as nuk do të ndodhi.

*Fier-* Unë di që listë e barnave esenciali duhet të jetë serum, duhet të jetë një gjilpërë kur shkon me sëmundje zemre. Këtu serum të gjesh, është fat i madh, të tjerat as mos i kërko. Shko shiko sa farmaci ka rreth spitalit. Si mbahen ato? Pse rrinë aty? Ka më shumë farmaci se njerëz. Se e dinë ata që aty do përplasemi. Unë sdua listë. Dua ilaçe. Listën jepjuani mjekëve ta lexojnë. Listën jepjuani drejtorëve që ta dinë.

Neve sna duhet lista, ne na duhen ilaçet.

Skepticizmi i pacientëve për përmirësimin e situatës së Urgjencës në të gjitha spitalet e vendit veçanërisht në rrethe, është i lartë.

Shoqata Together for life, përmes portalit Pro Pacientit, si një portal me ndjekës kryesisht pacientë dhe ofruer të shërbimit shëndetësor, ka krijuar një sondazh me temë:

Gjatë kohës së qëndrimit në urgjencë KAM / NUK KAM blerë ilaçe privatisht ... Rezultatet kanë dalë : **72 % e qytetarëve janë shprehur se kanë blerë**

**ilacë privatisht** dhe 28% e qytetarëve janë shprehur se ilaçet kanë qënë në urgjencë.



---

## 2.7 PERCEPTIMI I OFRUESVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR PËR LISTËN E BARNAVE ESENCIALE

Mungesa e barnave në shërbimin shëndetësor, veçanërisht në urgjencë është një nga arsyt kryesore të lakuara, që nxit dhunën verbale dhe fizike midis mjekëve dhe pacientëve. Për shkak të kontaktit të drejtpërdrejtë me pacientët, fjalia “shko blije në farmaci” është kthyer në një problem që nxit konfliktin dy palësh. Afishimi i Listës së Barnave Esenciale, nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale është bërë për të rritur transparencën dhe rritur përgjegjësinë e drejtuesve të spitaleve në drejtim të menaxhimit. Pasi është nënkuptuar se mungesat e barnave që janë pjesë e paketës së Listës së Barnave Esenciale vijnë për shkak të keqmenaxhimit, dhe jo të pamundësisë. Si e perceptojnë mjekët? Të pyetur nga shoqata Together for life, disa prej mjekëve, janë shprehur se:

*“ Është si të hapësh inventarin dhe ti thuash pacientit “këto janë ilaçet që duhet të jenë ketu dhe nëse nuk janë këtu është se dikush ka menaxhuar keq lekët, jo sepse ska lek. Në logjikën time kjo më shumë nxit konflikt se shuan konflikt. Nëse kjo bëhet për mjekët, mjekëve duhet tu vihen përpara protokollet mjekësore.*

*Flitet sot për gabim mjekësor? A mund të ketë gabim mjekësor nëse nuk ka protokolle mjekësore? Mendoj se këto janë populizma, për të bindur psikologjinë e njerëzve që diçka po bëhet dhe masat po shtrëngohen.”*

*“Çdo shërbim duhet të ketë paketën e listës së barnave esenciale. Në këto kushte, a është fotokopjuar një Listë Barnash e miratuar (nga KUSH?) për të gjitha shërbimet dhe është varur në mur, apo janë ulur personat kompetent dhe kanë miratuar Listën e Barnave Esenciale për çdo shërbim? Nëse kjo gjë nuk është bërë, nuk e kuptoj rëndësinë e afishimit të kësaj liste. Megjithatë besoj se u shërben më shumë mjekëve se pacientëve.”*

---

## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

---

## PËRFUNDIME

Nga monitorimi i kryer në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitalit Rajonal të Lezhës dhe Spitalit Rajonal të Fierit ka rezultuar se:

1. Praktika administrative për afishimin e Listës Esenciale të Barnave në tre spitalet publike të mësipërme nuk është e unifikuar. Vetëm Drejtorja e Spitalit Rajonal Lezhë ka miratuar dhe publikuar një Urdhër për njoftimin e pacientëve se, të gjitha medikamentet për përdorim spitalor ndodhen në farmacinë e spitalit.
2. Lista e Barnave Esenciale është afishuar në një vend të dukshëm për informimin dhe njohjen nga pacientët në të gjitha shërbimet e Urgjencës që funksionojnë pranë Spitaleve të monitoruara;
3. Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë pranon që ka siguruar 90 % të ilaçeve që përmban Lista Esenciale e Barnave duke informuar që 10 % e kësaj liste mund të mos sigurohet për plotësimin e nevojave të pacientëve;
4. Megjithëse, Spitali Rajonal Lezhë konfirmon se, Lista e Barnave Esenciale është shpallur në të gjitha repartet (pavijonet) e Spitalit përfshirë edhe shërbimet e Urgjencës, në 4 pavijonet/shërbimet të këtij Spitali nuk u konstatua afishimi i kësaj liste.
5. Në ndonjë shërbim specifik sikurse është shërbimi i Ortopedisë në Spitalin Rajonal Lezhë ishte afishuar lista e materialeve bazë që siguron spitali;
6. Përveç Spitalit Rajonal Fier (duke përjashtuar shërbimin e Pediatriisë), lista e Barnave Esenciale nuk është afishuar në pavijonet/shërbimet e tjera të Spitaleve të monitoruara, sikurse është angazhuar Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
7. Të tre spitalet kanë konfirmuar se nuk kanë patur vështirësi me sigurimin e ilaçeve të Listës së Barnave Esenciale, pasi përmes marrëveshjes kuadër mbulohen nevojat për medikamentet që përmban kjo Listë.

---

## REKOMANDIME

Krijimi i bashkëpunimit të strukturuar në mes shoqërisë civile dhe qeverisë është shumë i rëndësishëm në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Shqipërisë, pasi në shumë raste roli i shoqërisë civile qoftë në zhvillimin e demokracisë së brendshme apo në procesin e integritimit evropian ka qenë esencial.

Ky ndërveprim i bazuar në njohjen e vlerave reciproke do të arrijë që të ndikojë për mirë në jetën e qytetarëve të vendit. Procesi i bërjes së politikave, ligjeve dhe dokumenteve tjera zyrtare, si dhe monitorimi i zbatimit të tyre në Shqipëri si kompetencë e organeve të zgjedhura, në nivel qendror dhe atë lokal, duhet të garantojë dhe inkurajojë përfshirjen edhe të palëve tjera jashtë autoriteteve publike.

Në kuadër të forcimit të rolit dhe përmbushjes së misionit dhe vizionit të vet Shoqata Together for life sjell ekspertizën e saj dhe njohuritë mbi gjendjen lokale si dhe pikëpamjet me nevojat dhe shqetësimet e shoqërisë në raport me sistemin shëndetësor . Këto këndvështrime jo vetëm që janë esenciale për të siguruar respektimin e të drejtave dhe lirive – por gjithashtu edhe për një politikëbërje të mirë të ndërtuar me konsensus të gjerë.

Shoqata Together for life shpreh falënderime për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe spitaleve: QSU Nënë Tereza, Spitalin e Fierit dhe Spitalin e Lezhës të cilët kanë qenë bashkëpunues duke u përgjigjur në kohë dhe ndihmuar mbarëvajtjen dhe përmbylljen e procesit të monitorimit.

Pas monitorimit të spitaleve për afishimin e Listës së Barnave Esenciale, informimit dhe ndërgjegjësimit të pacientëve dhe publikut në përgjithësi lidhur me të drejtën për shërbime të kujdesit shëndetësor adekuat, rekomandimet që shoqata Together for life përcjell, janë si më poshtë vijon:

- Në përmbushje të angazhimit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për sigurimin e barnave esenciale në shërbimin e urgjencës, në të gjitha spitalet, në kuadër të përmirësimit të shërbimit, rritjes së kënaqësisë së pacientit ndaj shërbimit dhe rritjes së transparencës, spitalet duhet të zhvillojnë strategji për të adresuar kënaqësinë e pacientit
- Miratimi i një kalendari aktivitetesh ku Ministri përgjegjës për Shëndetësinë apo persona të deleguar të zhvillojnë takime me qytetarët në kuadër të monitorimit dhe vlerësimit të Urdhrave që synojnë rritjen e transparencës dhe përmirësimin e shërbimit.
- Ngritja pranë çdo spitali rajonal e një organi në përbërje të të cilit të jenë pacientë, detyra e të cilëve të jetë adresimi çdo 3 apo 6 muaj pranë spitalit, në prani të përfaqësuesve të

---

Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, problematikat e pacientëve dhe të jenë aktiv në dhënien e rekomandimeve për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me shërbimin shëndetësor.